



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 202, Datë 10.08.2022

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 10 MW, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE NR. 3038, FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU I FIERIT

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, gërma “a”, dhe nenit 38, pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1439/1prot., datë 08.08.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387 prot., datë 28.07.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “g”.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a” dhe “d”.
 - Dokumentacioni teknik për centralin fotovoltaiik - neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d” dhe pika 4.4.4, gërma “b”.

Dokumentacioni i munguar apo i plotësuar pjesërisht është si vijon:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor

neni 9, pika 2:

- **gërma “d”**
Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e prokurorisë dhe gjykatës së Rrethit Durrës, për vetë shoqërinë.
- **gërma “e”**
Shoqëria duhet të depozitojë informacion nëse është bërë efektive organigrama sikurse parashikuar, si dhe të paraqesë licencën e drejtuesit teknik elektrik.
- **gërma “f”**
Në referencë të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 417, datë 15.06.2022, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 3038, Fshati Povelçë, njësia administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit, nga shoqëria “EZ-5 ENERGY” shpk”, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën përkatëse me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe informacion/dokumentacion në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiik.

Dokumentacioni teknik për Centralin Fotovoltaiik

neni 9, pika 4.4.2

Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat mbi gjatësinë e linjës.

Leje nga institucione të tjera

neni 9, pika 4.4.5.

- **gërma “b”**
Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen/VNM përkatëse për centralin fotovoltaiik 10 MW të shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.

- Gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë në formatin origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin, dokumentacionin sipas përcaktimeve të gjermës “b” dhe “c”, pika 3, të nenit 9; gjermës “a”, “b” dhe “c” të pikës 4.4.4 të nenit 9; si dhe gjermës “a” të pikës 4.4.5 të nenit 9.
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gjërma “a” të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se në Studimin e Fizibilitetit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik 10 MW, të shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. jetëgjatësia e burimit rezulton 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 MW, për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI